



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr 713/4 Prot

Tiranë, më 28.03.2019

RELACION

**MBI VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDATIT PËR
ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

Drejtuar: Zonjës Arta MARKU, PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nga: SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Pas "Thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit", të datës 05.03.2019 të Prokurores së Përgjithshme, për vendin vakant të hapur të një anëtari në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, z. Vatë Staka, me detyrë prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Shkodër, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 713/3 datë 20.03.2019.

Në mbështetje të nenit 109/1 i ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësië", Sektori i Burimeve Njerëzore, ka bërë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatit prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe konstatoi se:

- Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të parashikuara nga neni 105 i ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësië", janë si vijon:

- në kohën e kandidimit, të kenë ushtruar funksionin e prokurorit për të paktën 10 vjet;
- në kohën e kandidimit, nuk duhet të jenë drejtues të një zyre prokurorie ose anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata prokurorësh, sindikata prokurorëshetj.;
- të jenë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

e) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

ë) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të aferm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

-Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për shprehje interesi, në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është si vijon:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;

dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

e) informacion mbi të afermit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afermit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor;

ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Kandidatura e paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në përputhje me afatin ligjor është depozituar kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, pas hapjes së vendit vakant për një anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të Vendimit të ardhur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me nr. 6, datë 28.02.2019, për ndryshimin e vendimit nr. 42, datës 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të Subjektit të Rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari, e cila ishte anëtare pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë e zgjedhur nga rradhet e prokuroreve të Prokurorisë së Shkallës së Parë.

Nga Prokuroritë e Shkallës së Parë.

1. Vatë Staka - kërkesë protokolluar me nr. 713/3, datë 20.03.2019.

Verifikimet e kryera .

- Lidhur me eksperiencen, vlerësimet e punës dhe masat disiplinore u kryen verifikimet e nevojshme nga Sektori i Burimeve Njerezore;
 - Z. Staka ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 20 vjetësh.
 - Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit.
 - Nga verifikimi i dosjes personale rezulton se është vlerësuar “ shumë mire” dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale;
 - Nuk ka masa disiplinore në fuqi dhe asnjë masë në karrierën e tij.
- Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, bashkëlidhur dëshmia;
- Për verifikimin e pikës “dh” “e”, për kushtet, kandidati ka paraqitur deklaratat, dhe nga ana jonë është kërkuar konfirmimi dhe në Autoritetin për Informimin mbi dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” dhe me Vendimin Nr. 81, datë 02.05.2018”, na është kthyer përgjigje dhe rezulton se për **z. Vatë Staka nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit , në emër të tij.**
- Nga verifikimi i dokumentacionit që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar, në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

Përfundime:

Përsa më sipër dhe konfirmimit në detyrën e magjistratit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me **Vendimin nr.30 datë, 03.07.2018**, Sektori i Burimeve Njerezore, arrin në përfundimin **Zoti Vatë Staka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës parë Shkodër, plotëson kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.